

[Kreu](#) / [Shtypi](#) / **Njoftimet për shtyp**

Njoftimet për shtyp

Njoftime të mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës



Konferenca për shtyp

Fjalime, intervista, artikuj



Kalendarë



Kalendar i festave zyrtare për vitin 2025

COVID-19

Evropa



SEPA

BANKA E SHQIPËRISË

NJOFTIM PËR SHTYP

Vendimmarrja e Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 6 gusht
2025

Data e publikimit: 06.08.2025

Në mbledhjen e datës 6 gusht 2025, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi që norma bazë e interesit të mbetet e pandryshuar në nivelin 2.5%, si dhe normat e interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë, të mbeten përkatësisht në nivelet 1.5%

dhe 3.5%.



Përveç këtij vendimi, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të japë miratimin paraprak për licencimin e degës së bankës së huaj "Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania" për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë.

"Ziraat Bank" është një bankë tregtare që operon në Republikën e Turqisë prej vitit 1863, me licencë të vlefshme bankare dhe leje operimi nën mbikëqyrjen e Agjencisë së Rregullimit dhe Mbikëqyrjes Bankare. Jashtë territorit të Turqisë, aktiviteti i saj shtrihet edhe në disa shtete të tjera, si: Mbretëria e Bashkuar, Bullgaria, Greqia, Kosova, Qiproja Veriore, etj.



Dega e bankës së huaj që ka marrë miratimin paraprak për licencë, brenda 12 muajve nga data e këtij vendimi, duhet të plotësojë të gjitha kushtet e parashikuara në ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, në mënyrë që të pajiset me licencën për fillimin e veprimtarisë bankare në vendin tonë.

Në përfundim, Këshilli Mbikëqyrës u njoh dhe me informacione të tjera mbi aktivitetin e përditshëm funksional dhe operacional të Bankës së Shqipërisë.

Copyright © 2025 Banka e Shqipërisë. Të gjitha të drejtat të rezervuara.